

## ALBANSK

### Fëmiu i Juaj tani e ka mundësinë për caktimin e një mentori (përkrahës) personal në periudhën kohore

Bilbil udhëheqet nga \_\_\_\_\_ në bashkëpunim me Ministrinë për Fëmijët dhe Barazi.

Bilbil bazohet në parim mentori nga shkolla e lartë në Mallmo të Suedisë. Rreth 1000 fëmijë të moshës shkollore kanë pasur mentor personal përgjatë një viti shkollor qysh se nga starti i 1997. Bilbil ekziston sot në shtatë shtete evropiane.

Përmes Bilbil ju ofrohet fëmijëve të moshës 8-12 vjet me prejardhje si pakicë një mentor përgjatë një viti shkollor. Kush do të caktohet si mentor i fëmiut Tuaj varet nga dëshirat, nevojat dhe interesat e saj/ tij.

Fëmiu Juaj dhe mentori do të takohen një herë në javë, pas mësimit, rreth dy-tri orë. Mbi kohën vendosni ju bashkë me mentorin. Është me rëndësi që fëmiu mos të ketë aktivitete tjera të shumta, por të ketë kohë të takohet me mentorin e vet.

Personi që caktohet si mentor për fëmiun Tuaj studjon në \_\_\_\_\_. Mentorët marrin udhëzime të rregullta dhe paguhen për punën e tyre. Referencat e mentorve verifikohen para se të punësohen. \_\_\_\_\_ i interviston studentët dhe i kontrollon referencat dhe sjelljen e tyre para se të emrohen si mentor.

Fëmiu Juaj e fiton një person plotësues për tu shoqëruar dhe për tu bërë shok me atë. Ky person i rritur do të jetë një shembëlltë për fëmiun. Mentori dhe fëmiu vendosin bashkarisht se çka do të bëjnë. Ata si psh. Mund të takohen në shtëpi tek njëri-tjetri apo të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme. Qëllimi është që këto aktivitete të jenë të përditshme dhe n'rend të parë pa pagesë. Bilbil organizon gjithashtu edhe aktivitete të përbashkëta të cilat janë falas për fëmijët dhe mentorët si psh. filmi apo vizitë në teater. Të gjithë fëmijët dhe mentorët janë të siguruar nga fatkeqësitë përgjatë periudhës së takimit mes tyre.

**Nuk kushton asgjë ta kesh një mentor. Përkundrazi, prindërit apo kujdetarët paguajnë për fëmiun, si për shembull autobus/ tramvaj dhe eventualisht të hollat për hyrje në aktivitete.**

**Bilbil ved Nord Universitet  
Koordinues i projektit: Yan Zhao**

**E-posta: [yan.zhao@nord.no](mailto:yan.zhao@nord.no)  
Telefoni: 75517438/90761476**



## PËR FËMIJË DHE PRINDËR NË SHKOLLËN X

